

VENDIM
Nr. 45, datë 1.2.2023

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 234, DATË 20.4.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE
PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA
INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 12, të vendimit nr. 234, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas shkronjës “f” shtohen shkronjat “g” dhe “gj”, me këtë përmbajtje:

“g) punonjësve në pozicionet “laborant” dhe “teknik i mesëm aparaturash” në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

gj) punonjësve në pozicionin “punëtor mirëmbajtjeje (krematoriumi)” në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, do të përballohen nga fondet e miratuara për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2023.

KRYEMINISTËR
Edi Rama